



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 329 Akti

Nr. 559 Vendimi
Tiranë, më 8.9.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Xhensila Pine	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ester Arapi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 8.9.2022, mori në shqyrtim, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Bujar Memia**, ish-prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Bujar Memia është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 16.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Bujar Memia do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Valbona Sanxhaktari dhe Xhensila Pine, e cila u zgjodh edhe relatore e çështjes.

3. Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe i njoftoi trupin gjykues që do të vijonte me procesin e saj administrativ të rivlerësimit. Nga anëtarët e trupit, si dhe nga subjekti i rivlerësimit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit:

- a. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 sipas nenit 35;
- c. plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

6. KLP-ja, bazuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 148/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka vlerësuar dhe ka pranuar kërkesën e ILD-së, pasi prokurori shkarkohet nga këshilli kur: *(a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.*

7. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 148/d, pika 2, përcakton në mënyrë taksative se prokurori shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës.

8. Subjekti i rivlerësimit Bujar Memia ka paraqitur ankim në datën 20.4.2021, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit kundër vendimit nr. ***, datë 31.3.2021, të KLP-së dhe është regjistruar pas plotësimit të dokumentacionit në datën 30.4.2021.

9. Bazuar në pikën 7, të nenit 179, të Aneksit të Kushtetutës, në germën “b”, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Posaçëm i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

10. Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka publikuar vendimin nr. 1 (JD), datë 30.5.2022, me të cilin ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit të magjistratit Bujar Memia kundër vendimit nr. ***, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Bujar Memia”. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare”.*

11. Vendimi nr. 1(JD), datë 30.5.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, shpallur në datën 12.7.2022, është botuar në fletoren zyrtare nr. 108, datë 29.7.2022.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Trupi gjykues konstaton se z. Bujar Memia ka qenë me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

14. Në referim të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, përcaktohet se: “statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni”.

15. Trupi gjykues u njoh me vendimin nr. ***, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për shkarkimin nga detyra të prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë Bujar Memia, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës sipas procesit të iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

16. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka arsyetuar në pikën 48, të vendimit nr. ***, datë 31.3.2021, se legjislacioni në fuqi dhe, konkretisht, neni 124 i ligjit nr. 96/2016 përcakton se: *[Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer ...]. Ky kriter është vlerësuar i përmbushur, pasi sjellja e magjistratit është parashikuar si shkelje disiplinore nga germa “a”, e pikës 2, të nenit 148/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon shprehimisht se: “Prokurori shkarkohet nga detyra kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës”.*

17. KLP-ja, në përfundim të procedurës administrative, ka analizuar dhe arsyetuar në vendimin e saj veprimet dhe mosveprimet e prokurorit Bujar Memia, duke arritur në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e tij. Vendimi nr. ***/*** plotëson kërkesën kushtetuese e të qenit i arsyetuar, në kuptim të përmbajtjes së nenit 99, pika 2 dhe nenit 100 të Kodit të Procedurës Administrative, pasi përmban përshkrimin e fakteve dhe argumenteve në lidhje me shkeljet e rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe është shoqëruar me provat përkatëse. Këshilli arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga ILD-ja është e bazuar në ligj dhe në prova dhe se ndaj magjistratit Bujar Memia duhet të vendoset masa disiplinore “shkarkim nga detyra”, bazuar në germën “a”, të pikës 2, të nenit 148/d, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në germën “a”, të pikës 1, të nenit 111, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Pas shqyrtimit të ankimit të magjistratit Bujar Memia nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, datë 30.5.2022, është marrë vendimi nr. 1 (JD), “Për mospranimin e ankimit të magjistratit Bujar Memia kundër vendimit nr. ***, datë 31.3.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Bujar Memia. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyjnë në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare”.

19. Vendimi nr. 1 (JD), datë 30.5.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 108, datë 29.7.2022.

20. Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen. Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar “*pamundësinë në objekt apo qëllim*”, ku sipas kësaj dispozite, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

21. Në zbatim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Bujar Memia, pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Bujar Memia, pa një vendim përfundimtar, për shkak se ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 8.9.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Xhensila PINE
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ester Arapi